



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 110/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, paraqitur kundër Anita Cucoviq kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga Koalicioni VAKAT, dega në Pejë, për shkak të vendosjes të posterit në ndërtesën publik për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 04.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ndërsa Koalicioni VAKAT, dega në Pejë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 400 (katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 03.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK dega në Pejë, në të cilën pretendohet se me datën 02.06.2014 rreth orës 14:00 kanë vrejtur se në ndërtesën publik të Postës në Pejë është vendosur posteri i kandidates për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës Anita Cucoviq nga radhët e Koalicionit VAKAT. Andaj me këtë veprimi është bërë shkelje e nenit 4 paragrafi 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, pretendohet në ankesën e këtij subjekti.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 03.06.2014 e informoi subjektin politik VAKAT, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 04.06.2014, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga Anita Cucoviq kandidate për deputete të Kuvendit të Republikës të Kosovës me të cilën theksohet se pretendimet e LDK-së janë të pa baza. Ajo shtojë se ka dalë në vendin e ngjarjes por nuk ka gjetur posterin në vendin e pretenduar dhe me këtë e ka argumentuar me dy fotografi në të cilat shihet që nuk ekziston posteri në atë vend, po ashtu me datë 27 deri me 03.06.2014, ka qenë në udhëtim jashtë vendit dhe si dëshmi ka sjellë biletat e udhëtimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se Koalicioni VAKAT ka vendosur poster në ndërtesën publike të Postes në Pejë, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se koalicioni VAKAT, pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar posterin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se Koalicioni VAKAT ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se "Është e ndaluar të vendosen posterat apo pllakatat brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave gjatë fushatës zgjedhore" duke pasur parasysh se nga ana e koalicioni VAKAT është larguar posterin në fjalë, menjëherë pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për Ndërmarr Masat Përmirësuese nga PZAP-i, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 110/2014 më datën 04.06.2014.



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*